



SHOQATA E PRODHUESVE  
TË QUMËSHITIT TË KOSOVËS  
KOSOVO ASSOCIATION OF  
MILK PRODUCERS KAMP



Kingdom of the Netherlands

"Commissioned by the Netherlands Enterprise  
Agency and funded by the Ministry of Foreign Affairs"

# MENAXHIMI I FERMËS

## SI TË PRODHOJNË LOPËT MË SHUMË QUMËSHT



**AERES**  
UNIVERSITY OF  
APPLIED SCIENCES  
DRONTEN





**GJENDJA NORMALE E LOPËS ËSHTË**

**DRITARET**

**Hapësira e vendit (shtratit) për lopë qumështore - Sistem I lidhur**

**HAPËSIRA E VENDIT (SHTRATIT) PËR LOPË QUMËSHTORE - SISTEMI I LIRË I MBAJTJES**

**GRAZHDI**

**LARTËSIA E SHTALLËS**

**VENTILIMI**

**KANALET PËR HEDHJE TË PLEHUT**

**SHTROJA PËR SHTRATIN E LOPËS**

**UJËPIRËSET E LOPËVE**

**KORIDORET E BRENDSHME TË FERMËS**

**NDRIÇIMI**

**HAPËSIRA PËR TRAJTIMIN E LOPËVE**

**HAPËSIRA PËR PARA MJELJEN E LOPËVE (VENDI KU QËNDROJN LOPËT PARA SE TË MJELJEN)**

**RUAJTJA E USHQIMIT**

**RUAJTJA E PLEHUT - DEPOJA E PLEHUT**

**DIZAJNI I STALLËS ME SISTEM TË LIRË TË MBAJTJES SË LOPËVE**

**Procesi i ngritjes së lopës, kur lopa është e lirë**

**Kush është Shoqata e Prodhuesve të Qumështit**

## GJENDJA NORMALE E LOPËS ËSHTË:

- Pa etje, uri apo kequshqyerje
- Pa bezdi/jo rehati trupore
- Pa dhimbje, lëndime dhe sëmundje
- E lirë për sjellje normale
- Pa frikë dhe stres kronik
- Rreth 7 deri 12 racione ushqimore ditore
- Secilin ushqim e merr çdo 45 minuta
- Të ngrëna merr 6 deri 8 orë në ditë
- Mëshqerrat hanë më shpesh por marrin më pak ushqim për racion
- Marrja e ushqimit është 4% e peshës trupore
- Një lopë ripërtyp 8 deri 10 orë çdo ditë
- Ripërtypja merr 45 minuta për çdo herë
- Pas aktiviteteve të rëndësishme të mjeljes dhe ushqimit, pas dy orësh rreth 60 % e të gjitha kafshëve duhet të jenë duk u ripërtypur
- Rreth 60 përtypje/mbllaçitje çdo herë
- Rreth 3 lëvizje ripërtypjeje në 2 minuta
- Normalisht 60 litra ujë në ditë (25 deri 175) varësisht nga temperatura, lagështia dhe njomësia e ushqimit që marrin.
- Lopët pëlqejnë të pinë në enë të ulëta apo kovë
- Lopa pëlqen të jetë e lirë dhe e sigurt, gjatë pirjes s'bën të shohin rrezik
- Lopët preferojnë ujë të freskët të pastër
- Orar i rregullt pirje, ngrënie, pirje.
- Lopët pëlqejnë të pinë menjëherë pas mjeljes.
- Një lopë pushon - shtrihet 10-14 orë në ditë
- 30 % gjak shkon nëpër gji
- Për të prodhuar 1litër qumësht 300 litra gjak duhet të qarkullojnë neper gjirin e lopës
- Lopët prodhojnë shumë ngrohtësi, amoniak dhe lagështi
- Ventilimi është i rëndësishëm, lopët kanë nevojë për shumë oksigjen
- Lopët duan minimalisht 16 orë dritë - 200 lux.



- Hapësira e vendit (shtratit) për lopë qumështore – Sistem i lidhur

*Pesha e lopës prej 600 kg*

Gjatësia=1,75 / Gjerësia=1,20 m

*Pesha e lopës prej 700 kg*


Gjatësia =1,8 m / Gjerësia =1,20 m

*Pesha e lopës prej 800 kg*

Gjatësia = 1,85 / Gjerësia = 1,20 – 1,25 m

## HAPËSIRA E VENDIT (SHTRATIT) PËR LOPË QUMËSHTORE – SISTEMI I LIRË I MBAJTJES

- Gjatësia e shtratit të lopës tek sistemi i lirë i mbajtës së lopëve kur lopët janë kokë për kokë duhet të jetë 5 – 5.5 m.
- Kur ferma ndërtohet në një rendë, gjatësia e shtratit duhet të jetë 2.9 – 3.1 m prej murit përballë.
- Gjerësia e shtratit të lopës duhet të jetë 1.2 – 1.3 m, varësisht nga raca e lopëve



### *Dimensionet e boksave tek sistemi i lire i mbajtjes se lopëve*

## GRAZHDI

Ndërtimi i grazhdit në fermën me sistem të lidhur të lopëve duhet të jetë:

- Lartësia e grazhdit 15–20 cm
- Gjerësia e grazhdit 50–60 cm



Ndërtimi i grazhdeve në fermën me sistem të lirë të mbajtjes së lopëve:

- Lartësia e grazhdit duhet të jetë 40 cm
- Gjerësia e grazhdit duhet të jetë 65 – 70 cm
- Niveli i bazës së grazhdit duhet të jetë 10 cm më lartë nga vend qëndrimi i lopës

## LARTËSIA E SHTALLËS

Pika më e ulët e stallës së lopëve duhet të jetë 2.8 – 3 m

## VENTILIMI

- Gjerësia maksimale e fermës nuk duhet të jetë më shumë se 38 metra, nëse gjerësia është më e madhe ka problem me qarkullimin e ajrit.
- Mbylleni pjesën veriore të fermës kur temperatura të bjerë nën nivelin e rehatisë së lopëve
- Izoloni të gjithë çatinë e kulmit.
- Hapja e sipërme e kulmit është e domosdoshme, për të mundësuar qarkullimin e ajrit me dimensione prej 0,35–0,60 m
- Instalo ventilatorët në fermë sidomos në fermtat e lopëve qumështore dhe përdorimi i tyre në temperatura mbi 20 gradë.





## KANALET PËR HEDHJE TË PLEHUT

Kanali i plehut - gjerësia prej 0,40 deri 0,45 m, thellësia deri në shtrojë 0,35 m

Kanali i plehut të lëngshëm - gjerësia prej 0,60 deri 0,80 m, thellësia 0,70 m

Hapësira prej kanalit të urinës deri në mure duhet të jetë 1.5 m. Kjo hapësirë është shumë e rëndësishme sidomos tek sistemi i lidhur i mbajtjes së lopëve.



## SHTROJA PËR SHTRATIN E LOPES

- Zalli është shtroje ideale për lopët, higjiena mbahet më mirë dhe numri i qelizave somatike në qumësht është më i ulët.
- Shtroja e thellë me kashtë po ashtu është shumë e përshtatshme por duhet më shumë punë, duhet sasi e madhe e kashtës për të mbajtur higjienën në nivelin e duhur.
- Plehu i terur (nëse kemi pajisjen për terjen e plehut-seperatotin e plehut) është shumë i përshtatshëm nëse plehu është i terur mirë dhe menaxhohet mirë
- Shtrojat e gomës duhet të jenë adekuate për lopë, mos të jenë të rrëshqitshme dhe të jenë të buta
- Tallashi i drurit apo byku i drurit mundë të përdoret për shtroje por nuk duhet të jetë shumë i vrazhdë.



## UJË PIRËSET E LOPËVE

- Për çdo 20 lopë duhet të ketë një ujë pirëse
- Ujë pirëset duhet të vendosen në vendet afër sistemit të mjeljes në mënyrë që pas mjeljes lopët të kenë në dispozicion ujë
- Gjate dimrit duhet të bëhet ngrohja e ujit për të parandaluar ngrirjen dhe për të ngrohur ujin në 15° C në mënyrë që lopët të konsumojnë sasinë e mjaftueshme të ujit.
- Lopët me prodhimtari të lartë të qumështit mundë të pijnë ujë deri në 170 - litra në dite.



## KORRIDORET E BRENDSHME TE FERMËS

- Është ideale që çdo këndë ku paraqitet rrezik për dëmtimin e lopëve të mbulohet me goma
- Grazhdi i lopës duhet të jetë 10 cm më lartë se niveli ku qëndrojnë lopët
- Gjerësia e vendit të ushqimit për lopë duhet të jetë 75 – 80 cm
- Korridoret lidhëse të fermës ku është e vendosur ujë pirëset duhet të jenë të gjera 3.6 m, nëse nuk kanë ujë pirse gjerësia e korridorit duhet të jetë 2.4 m
- Fermat e mëdha, korridori deri te dhoma e qumështit duhet të jetë 6 m i gjere
- Skreperët e plehut duhet të programohen që të lëvizin çdo dy orë





## NDRIÇIMI

- Ndriçimi i fermës duhet të jetë 200 lux ose në fermë duhet të ketë ndriçim sa të lexohet gazeta. Po ashtu në fermë duhet të ketë më shumë se 12 ore dritë.
- Lopët nuk duhet të lëvizin nga drita në errësirë ose anasjelltas.



## HAPËSIRA PËR TRAJTIMIN E LOPËVE

- Fermat e mëdha duhet të kenë hapësirën për trajtimin e thundrave të lopëve
- Fermat e mëdha duhet të kenë hapësirën për inseminim, trajtim për sëmundje të ndryshme
- Vendin e veçantë për pjellje, lopët e sëmura (2% e hapësirës për pjelljen e lopëve dhe 2 % hapësirës për lopët e sëmura)
- Hapësirë e veçantë për ti mbajtur lopët dy jave para dhe pas pjelljes, vendi duhet të ketë shtrojë me kashtë
- Lopët kur ndahen në bokse të veçanta duhet të jenë afër lopëve tjera në mënyrë që të shohin pjesën tjetër të tufës.

## HAPËSIRA PËR PARA MJELJEN E LOPËVE (VENDI KU QËNDROJN LOPËT PARA SE TE MJELJEN)

- Fermat e mëdha duhet të kenë hapësirë 1.4 m<sup>2</sup> për lopë, (duhet të llogaritet nga numri i lopëve në një mjelje) në mënyrë që lopët të kenë hapësirë të mjaftueshme për pritje para mjeljes



## RUAJTJA E USHQIMIT

- Fermat e mëdha: ndërtoni siloset e silazhit në mënyrë që të keni mundësi që ta korrni dhe të përgatiteni silazhin për një ditë.
- Po ashtu është shumë me rëndësi që marrja e silazhit në silos duhet të jetë 1.5–2 herë në javë, në mënyrë që të parandalohet ngrohja e silazhit pas hapjes.

## RUAJTJA E PLEHUT – DEPOJA E PLEHUT

- Kapaciteti i depos së plehut duhet të ndërtohet së paku për tre muaj
- Prodhimi i plehut është në varësi të madhësisë dhe nivelit të prodhimit të qumështit 20 - 25 m<sup>3</sup> / lopë / vit dhe 5 m<sup>3</sup> /vit për kafshët e reja/viçat.

## DIZAJNI I STALLËS ME SISTEM TË LIRË TË MBAJTJES SË LOPËVE

Dizajni i stallave të reja ka një influencë të madhe në shëndetin e lopës dhe në këtë mënyrë edhe të performancës së saj. Një vend pushimi optimal është esencial për lopët, për shkak se ato pushojnë shumë orë në ditë. Stallat e lira duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për të lejuar lopët të ngritën dhe të bien lehtë. Një lopë, ngritët natyrshëm nga një pozicion i shtrirjes duke u zgjatur përpara për 60 deri 70 centimetra në transferimin e shumicës së peshës përpara për të ndihmuar ngritjen e këmbëve të pasme. Për të arritur këtë lëvizje natyrale, një lopë duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur kokën përpara. Nëse nuk mund të zgjatet mjaftueshëm, do të jetë e vështirë për të që të ngritët në këmbët e pasme.

Nëse kufizohet shumë, lopa do të ngritet në këmbët e para fillimisht, si një kal, duke rrezikuar dëmtimin e gjirit. Duke pasur këtë parasysh, stallat e lira duhet të dizajnohen dhe të ndërtohen mirë, dhe të jenë të dimensioneve të domosdoshme për minimizimin e shanseve për lëndime të këmbëve dhe gjirit.

Pjesët e dizajnuara dhe të përmirësuara në mënyrë të veçantë mundësojnë ngritjen e lehtë të lopëve si rezultat i shkallës më të lartë të lëvizjes së lirë. Lopa nuk duhet të pengohet nga grazhdi apo pjesët tjera të stallës gjatë procesit të ngritjes. Një hapësirë e hapur e stallës së lirë mundëson lehtësi në lëvizje, sepse ofron hapësirë të mjaftueshme.

Nëse ana ballore e stallave të lira është e mbyllur me mur anësor, ngritja e kafshëve do të jetë më e komplikuar. Në një situatë të kështillë, lopa nuk është në gjendje të lëvizë në mënyrë të duhur përpara dhe prandaj hapësira shtesë është e nevojshme për lëvizjen e kokës përpara gjatë ngritjes. Stallat e gjëra të lira mundësojnë lopët e vogla të lëvizin tepër dhe si rezultat, bajgat e tyre mund të ndotin shtrojnë. Stallat e lira shumë të ngushta do të komplikojnë ngritjen dhe shtrirjen e lopës, me rrezikun e dëmtimit të gjirit dhe këmbëve.

Për më shumë, stallat e ngushta të lira janë të papërshtatshme dhe dekurajojnë përdorimin e tyre. Problem mund të shkaktojë shtrirja e lopëve në rrugëdaljet për lëvizje.

Nëse e kuptojmë mire procesin e ngritjes dhe shtrirjes së lopëve atëherë nuk do të bëjmë gabime gjatë ndërtimit të fermave. Në këto fotografi janë të paraqitura të gjitha fazat të cilat lopët i bëjnë gjatë ngritjes kur janë të pa penguara.

## Procesi i ngritjes se lopës, kur lopa është e lirë



Pika me ngjyrë portokalli do të shërbej si pikë referimi, kështu që ju mundë të gjykoni lëvizjen.



Koka e lopës e prek barin kur ajo tenton të ngritet. Nëse lopët janë të lidhura dhe grazhdi është i lartë paramendoni se sa me vështirësi lopa ngritet



Për të u ngritur pjesa e pasme, lopa duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme përpara



Gjat ngritjes lopa lëvizë kokën rreth 60 cm përpara



Për tu ngritur lopa duhet të vendos këmben përpara. Nëse shtrati i lopës nuk është adekuat dhe grazhdi jo adekuat, lopa ngritet me shumë vështirësi



Pasi që lopët tek ne janë të lidhura duhet ti kushtojmë kujdesë ndërtimit të shtratit dhe grazhdit të lopës.



SHOQATA E PRODHUESVE  
TË QUMËSHTIT TË KOSOVËS  
KOSOVO ASSOCIATION OF  
MILK PRODUCERS KAMP

## **Kush është Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës**

Shoqatë e prodhuesve të Qumështit të Kosovës

E përkrahur nga USAID/KCBS

Organizim i fermerëve në nivel të Kosovës

### **OBJEKTIVAT**

- Përmirësimin e standardeve të kualitetit dhe mbrojtjen e konsumatorëve
- Implementimin e standardeve të kualitetit dhe mbrojtjen e konsumatorëve
- Përmirësimin e aftësive të marketingut të prodhuesve të qumështit
- Krijimin e një ambienti të favorshëm fiskal dhe rregullave në industrinë konkurruese

### **TË ARRITURAT**

- Ngritje në nivelin menaxhues të fermave
- Përmirësim i të ushqyerit të lopëve qumështore
- Përmirësim i higjienës së qumështit
- Përmirësim racor dhe riprodhues
- Ndikim në përmirësimin e një ambienti të favorshëm

### **ÇKA OFRON KAMP-I?**

- Shërbime profesionale në menaxhimin e fermave
- Planë për ndërtimin e stallave
- Shërbime profesionale në ngritjen e riprodhimit në lopët qumështore
- Përgatitjen e racioneve të ndryshme ushqimore
- Shërbime në përmirësimin e kualitetit të qumështit të freskët
- Shërbime në mirëmbajtjen e thundrave

### **VIZIONI**

- Shoqatë e konsoliduar vendore në mbrojtje të interesave të prodhuesve kosovar të qumështit
- Një partner i respektuar në sektorin privat dhe në vendim-marrje në politikat bujqësore me institucionet qeveritare vendore
- Ofrim shërbimesh dhe trajnime anëtarëve të saj dhe fermerëve

